



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori I 2020

Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	8
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	9

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e parë të vitit 2020 dhe krahasimet me tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe me tremujorin e parë të vitit 2019, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”
Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e parë të vitit 2020 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (16 subjekte):**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
 3. DHL International (Albania) sh.p.k;
 4. TNT Express Albania sh.p.k;
 5. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex);
 6. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
 7. Youth Albania Professional Services (YAPS);
 8. E-KOMPLET sh.p.k;
 9. COEX shpk;
 10. Albanian Parcel Distribution shpk;
 11. Speed Couriers Albania (Albi Shkurta – person fizik);
 12. Intex Courier sh.p.k;
 13. Turboo Albania sh.p.k;
 14. Panorama Group sh.a;
 15. Flash Delivery Albania;
 16. Balkan Courier & Logistics sh.p.k.

Posta Shqiptare me VKD Nr.2581, datë 22.06.2015 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 rezultojnë 6,325,776 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

Tabela 1.1- Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e parë 2020 dhe krahasimi me tremujorin e katërt 2019¹ dhe me tremujorin e parë 2019.

Shërbime postare të ofruara	T1_2019	T2_2019	T3_2019	T4_2019	T1_2020	Ndryshim T1_2020/ T4_2019	Ndryshim T1_2020/ T1_2019
Posta Shqiptare sh.a							
1 Shërbim Universal Postar							
1.1 Postë brenda vendit	4.821.716	5.524.563	4.238.676	5.032.877	4.492.982	-10,7%	-7%
1.2 Postë ndërkombëtare	413.819	440.588	3.388.734	304.059	805.709	165,0%	95%
1,3 Totali 1.1+1.2	5.235.535	5.965.151	7.627.410	5.336.936	5.298.691	-0,7%	1%
2 Shërbim joniversal postar							
2.1 Postë brenda vendit	266.060	126.798	131.101	962.635	12.707	-98,7%	-95%
2.2 Postë ndërkombëtare	262	5.310	314	934	360	-61,5%	37%
2,3 Totali 2.1+2.2	266.322	132.108	131.415	963.569	13.067	-98,6%	-95%
3 Shërbim ekspres							
3.1 Ekspres brenda vendit	175.231	172.580	176.999	123.039	136.068	10,6%	-22%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	6.400	6.448	6.223	49.877	5.727	-88,5%	-11%
3,3 Totali 3.1+3.2	181.631	179.028	183.222	172.916	141.795	-18,0%	-22%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare							
4 Shërbim JoUniversal Postar							
4.1 Postë brenda vendit	147.651	155.986	186.595	208.183	221.482	6,4%	50,0%
4.2 Postë ndërkombëtare	10.702	10.515	9.771	10.953	9.650	-11,9%	-9,8%
4,3 Totali 4.1+4.2	158.353	166.501	196.366	219.136	231.132	5,5%	46,0%
5 Shërbim ekspres							
5.1 Ekspres brenda vendit	424.681	465.936	510.385	608.791	588.199	-3,4%	38,5%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	58.899	67.334	78.235	64.896	52.892	-18,5%	-10,2%
5,3 Totali 5.1+5.2	483.580	533.270	588.620	673.687	641.091	-4,8%	32,6%
6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6.325.421	6.976.058	8.727.033	7.366.244	6.325.776	-14,1%	0,0%


¹ Përditësuar të dhënat për shërbimin jouniversal postar duke shtuar të dhënat nga ofruesi i shërbimit postar Panorama Group sh.a

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T1 2020

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,453,553	86%
<i>Of. e tjerë</i>	872,223	14%
<i>Totali</i>	6,325,776	100%

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.2 sa më sipër, për tremujorin e parë të vitit 2020 Posta Shqiptare zë rreth **86%** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **14%**.

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e parë 2020 ka realizuar 5,453,553 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 1,019,868 objekte postare më pak se tremujori i katërt 2019, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e parë 2020 kanë realizuar 20,600 objekte postare më pak se në tremujorin e katërt të vitit 2019.

Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1-2020

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
5,298,691	244,199	782,886	6,325,766
83.8%	3.9%	12.4%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 83.8% ose 5,298,691 objekte postare, ndjekur nga shërbimi ekspres me 12.4% ose 782,886 objekte postare. Shërbimi jo universal postar zë 3.9% ose 244,199 objekte postare.

Grafiku 1.2 Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhet në nivelet rreth 84% për tremujorin e parë të vitit 2020. Nga krahasimi i periudhës T1-2020 me periudhën T4-2019, vërehet një rënie e numrit të shërbimeve postare në masën 1,040,468 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të parë të vitit 2020 me tremujorin e parë të vitit 2019 vërehet një rritje e shërbimeve postare në masën rreth 355 shërbime.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare


Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T1-2020

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,492,982
Postë ndërkombëtare	805,709
Totali	5,298,691

Nga të dhënat e tabelës 1.4 vihet re se gjatë tremujorit të parë 2020, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,298,691 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 4,492,982 ose 85%, dhe Postë ndërkombëtare 805,709 objekte, ose 15%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 3,851,984 shërbime për objekte të thjeshta dhe 640,998 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 89,794 objekte postare të pranuar në Shqipëri

dhe të dërguara jashtë vendit dhe 715,915 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muajor



3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
Shërbim universal postar	5,298,691	97,2%
Shërbim jo universal postar	13,067	0,2%
Shërbim ekspres	141,795	2,6%

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 5,298,691 objekte postare ose 97.2%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 141,795 objekte postare ose 2.6%, dhe shërbimi jo universal me 13,067 objekte postare ose 0.2%.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të vitit 2019 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2020, nga ku vihet re një rënie e theksuar për shërbimin jo universal dhe rënie për shërbimin univaler postar dhe shërbimin ekspres, krahasuar kjo me tremujorin e mëparshëm.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Sh	13,067	5%
Of. e tjerë	231,132	95%
Totali	244,199	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i kanë Ofruesit e tjerë me 231,132 objekte postare ose 95% të tregut, kundrejt Postës Shqiptare me 13,067 objekte postare ose 5%.

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e parë 2020 krahasuar me tremujorin e katërt 2019 janë ulur në mënyrë të ndjeshme për Postën Shqiptare me 950,502 objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë rritur me 11,996 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rënie e ndjeshme e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim duke arritur në 5% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019, ku pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ishte rreth 63%.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 përbëhej nga 234,189 objekte brenda vendit dhe 10,010 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2020, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2019, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e parë 2020.

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Shqiptare	141,795	18%
Of. e tjerë	641,091	82%

Totali T1-2020 | 782,886 | 100%

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2019, sikundër vërehet rënie në shërbimet postare ekspres për tremujorin e parë të vitit 2020 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T4–2019). Gjithashtu, për shërbimin ekspres vërehet një rënie e pjesëve të tregut për Postën Shqiptare, ku nga rreth 27% të tregut për këtë tregues në tremujorin e parë të vitit 2019, pjesa e tregut të Postës Shqiptare në tremujorin e parë të vitit 2020 ka arritur në rreth 18%, përkundrajt rreth 82% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 724,267 objekte postare ose 93%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 58,619 objekte postare ose 7%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 39,582 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e madhe se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 19,037 objekte.